

## PROKURË E POSAÇME

**“Media A.B.C. Holding” BV**, një kompani private me përgjegjësi të kufizuar, me seli në Mbretërinë e Holandës, me zyrë të regjistruar në: Strawinskyalaan 1431, 1077XX Amsterdam, Holandë, e regjistruar në Dhomën e Tregtisë të Amsterdimit me numër KVK-je: 85264679, Anëtare e vetme e Bordit të së cilës është “Dutch Trust Management” B.V., përfaqësuar nga drejtori i saj i autorizuar z. Nikita Vinogradov (këtu e tutje i referuar si “Dhënësi”) I JEP znj. Dorina Zhuka, me shtetësi shqiptare, lindur më 12.06.2000, identifikuar me pasaportë numër: BA1590783 (këtu e tutje referuar si “përfaqësuese”), një prokurë të veçantë:

- për të përfaqësuar Dhënësin përpara çdo individi, subjekti ligjor, zyrë noterie dhe organe qeveritare, në lidhje me regjistrimet e çdo lloji të kryera për personat juridikë/sipërmarrësit, tek të cilët Dhënësi është palë;
- për të nënshkruar Marrëveshjen e Blerjes së Aksioneve dhe Aktin e Pranimit të Aksioneve, të cilat lidhen të dyja me blerjen 100% të aksioneve që znj. Efthymia Gkouma zotëronte në kompaninë “A.B.C. MANAGEMENT” SHPK, një kompani me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar në bazë të ligjeve të Republikës së Shqipërisë, me kod identifikimi të tatimpaguesit (NUIS): L91911028V, për një çmim total blerjeje prej 100 Eurosh (njëqind eurosh).
- për të përfaqësuar “Media A.B.C. Holding” BV në Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve të “A.B.C. MANAGEMENT” SHPK, më pas të “Media A.B.C. Holding” BV duke qenë se bëhet aksionare me pjesëmarrje 100% në aksionet e “A.B.C. MANAGEMENT” SHPK;
- për të votuar në emër të “Media A.B.C. Holding” BV në lidhje me miratimin e peneve të reja të Shoqërisë “A.B.C. MANAGEMENT” SHPK;
- për të nënshkruar Vendime dhe/ose Proces-verbale mbledhjesh dhe nenet e reja të Shoqërisë “A.B.C. MANAGEMENT” SHPK;
- për të nënshkruar çdo dokumentacion tjeter të nevojshëm për lidhjen dhe zbatimin e Marrëveshjes për Blerjen e Aksioneve dhe çdo akt që lidhet me të, duke përfshirë, por pa u kufizuar, në dokumentacionin e nënshkruar përpara një noteri publik;
- për të paraqitur çdo dokumentacion dhe për të depozituar çdo aplikim të nevojshëm sipas ligjeve të Shqipërisë për regjistrimin e ligjshëm dhe të vlefshëm të Marrëveshjes për Blerjen e Aksioneve dhe njohjen e Dhënësit si Aksionarin e vetëm të “A.B.C. MANAGEMENT” SHPK, me një përqindje pjesëmarrjeje prej 100% në aksionet e kompanisë së përmendor.

**Të gjitha veprimet e përfaqësueses së caktuar të kryera brenda objektit të kompetencave të dhëna nga Dhënësi, siç listohen më sipër, do të gjykohen të vlefshme dhe në përputhje me vullnetin e Dhënësit.**

Kjo prokurë është e vlefshme deri në revokimin e saj nga personi i përfaqësuar nëpërmjet një akti tjetër notarial.

Ky akt u lexua me zë të lartë, u pranua dhe u nënshkrua nga:

## DHËNËSI

**“Media A.B.C. Holding” BV**

(nënshkrimi) 7 prill 2022

**Përfaqësuar nga Anëtarja e Vetme e Bordit të Dutch Trust Management B.V.**

**Përfaqësuar nga z. Nikita Vinogradov**



Thodhor Kamberi